



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr.3 datë 01.02.2019

MBI

“SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SIPËRMARRËSIT “TELECOM ALBANIA” SH.A PËR SHTYRJEN E MËTEJSHME TË DATËS SË ZHVILLIMIT TË TENDERIT PUBLIK ME PROCEDURË TË HAPUR ME OBJEKT: “DHËNIA E TË DREJTAVE TË PËRDORIMIT NË BREZIN E FREKUENCAVE 800 MHZ (792-862 MHZ)”, REF. 1X10 MHZ I ÇIFTUAR-800-2018”, MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT DREJTUES NR. 47, DATË 5.7.2018”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Illir Zela	Kryetar
Znj.	Ketrin Topçiu	Anëtare
Znj.	Klarina Allushi	Anëtare

dhe sekretare Ina Nuellari, në mbledhjen e datës 01.02.2019, shqyrtoi çështjen me objekt:

- **“Shqyrtimi i kërkesës së sipërmarrësit “Telecom Albania” sh.a për shtyrjen e mëtejshme të datës së zhvillimit të tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 MHz)”, ref. 1x10 mhz i çiftuar-800-2018”, miratuar me vendim të Këshillit Drejtues nr. 47, datë 5.7.2018”.**

BAZA LIGJORE:

1. Neni 68, 69, pika 1, neni 114 dhe pika 1, neni 115, të Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008, *“Për Komunikimet Elektronike në RSH”*, i ndryshuar (*Ligji 9918/2008*);

2. Ligji Nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**Ligji 44/2015**).
3. Kreu III, Pika 6.2, e VKM-së Nr.1252 datë 10.09.2008 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënie e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, e ndryshuar (**VKM nr.1252**);
4. Rregullore e brendshme e Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2018 të KD të AKEP;
5. VKD nr.47, datë 05.07.2018 për “Miratimin e dokumentit të tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 mhz (792-862 mhz)”, ref. 1x10 mhz i çiftuar-800-2018;
6. Urdhri Nr. 404 Prot. datë 28.06.2018, i Kryetarit të KD-së të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike “Për zhvillimin e procedurës për konkurimin publik për dhënie të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 MHz)”, i ndryshuar;

KËSHILLI DREJTUES I AKEP

Pasi shqyrtoi materialin shkresor, të përbërë nga:

1. Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit (*Relacioni*);
2. Projekt Vendimi i formatuar dhe arsyetuar.

si edhe pasi e diskutoi në tërësi çështjen,

V Ë R E N:

1. Sipërmarrësi “Telecom Albania” sh.a, nëpërmjet shkresës me nr.508 prot, datë 29.01.2019, (administruar në AKEP datë 31.01.2019 me nr. 688/37 Prot) me objekt “Kërkesë për shtyrje të mëtejshme të datës së Tenderit për spektrin 800 MHz”, parashtron se :

Aksioneri kontrollues i shoqërisë “Telecom Albania” sh.a , është në procesin e arritjes së një marrëveshje për transferimin e të gjitha aksioneve të tij tek një grup investitorësh. Ky proces përfshin përmbylljen e disa detyrimeve nga palët, ndër të tjera edhe marrjen e pëlqimeve dhe miratimeve përkatëse nga shumë institucione. Prandaj finalizimi i këtij procesi mund të zgjasë deri në fund të muajit Prill 2019.

Për sa më sipër dhe në mënyrë që të shmangë ndonjë ndikim në miratimet eventuale të institucioneve pjesmarrës në këtë proces, “Telecom Albania” sh.a i kërkon AKEP, marrjen në konsideratë të shtyrjes së Tenderit për Spektrin 800 MHz të programuar, për t’u mbajtur në datë 7 Shkurt 2019, për një periudhë 3 (tre) mujore, me qëllim dhënien kohë për finalizimin e ndryshimit të pronësisë së shoqërisë.

Sipërmarrësi “Telecom Albania” sh.a., parashton këtë kërkesë bazuar në përcaktimet ligjore shprehur në pikën 6.2 të Kapitullit III të VKM-së Nr.1252, datë 10.09.2008 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, e ndryshuar, që përcakton se “AKEP, në çdo moment, përpara mbarimit të afatit për dorëzimin e ofertave për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë nga një kandidat, mund të bëjë ndryshime në dokumentin e tenderit, dhe mund të zgjasë afatin e depozitimit të ofertave”.

2. Këshilli Drejtues i AKEP, vlerëson pikësëpari rëndësinë strategjike për ekonominë e vendit të zhvillimit të mëtejshëm të rrjetit të telekomunikacionit, nëpërmjet nxitjes dhe zhvillimit të investimeve në këtë sektor.
3. Në këtë kontekst, harmonizimi i duhur i politikave, nismave por dhe zhvillimit të procedurave mjaft domethënëse në funksion të përmirësimit të ofrimit të shërbimit në fushën e telekomunikacionit, do të përmirësojë akoma më tej klimën e biznesit por dhe do të garantojë investime të qëndrueshme në interes të zhvillimit kombëtar. AKEP në përmbushje të objektivave rregullatorë angazhohet për të zhvilluar një procedurë konkurrimi objektive, transparente, jodiskriminuese dhe proporcionale.
4. Këshilli Drejtues i AKEP, pasi është njohur me kërkesën e lartpërmendur, thekson se mbetet maksimalisht i angazhuar të krijojë ndër të tjera kushte të favorshme për zhvillimin e një procedure tenderuese gjithpërfshirëse e që ka të bëjë me pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve të cilët operojnë në fushën e telekomunikacionit, duke shpresuar që dhe sipërmarrësi “Telekom Albania”, të marrë pjesë në procesin e tenderit publik për brezin 800 Mhz.
5. Këshilli Drejtues i AKEP, sjell në vëmendjen e sipërmarrësit “Telecom Albania”, se një nga elementët determinant për shtyrjen e datës së tenderit nga data 03.12.2018 në datën 07.02.2019, sanksionuar me vendim nr. 92 dt. 27.11.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP, i vlerësuar Suo Motu prej tij, ka qenë, citojmë tekstualisht: “Gjithashtu, shtyrja e procedurës së tenderit publik si rrjedhojë e ndryshimeve në dokumentat e tenderit, përmbush dhe kërkesën për shtyrje të paraqitur nga sipërmarrësi “Telekom Albania” sh.a, me Nr. Prot.7115, datë 26.11.2018 (administruar në AKEP me Nr.688/31,prot, datë 26.11.2018) me arsyetimin se ndodhet në procesin e shitjes së aksioneve, çfarë dhe vendos AKEP në pozitat e krijimit të një klime mbështetëse për biznesin dhe investimeve

të qëndrueshme në fushën komplekse dhe me dinamike të lartë zhvillimi, sikurse është fusha e Komunikimeve Elektronike”.

6. Në shkresën zyrtare të sipërmarrësit “Telekom Albania”, sqarohet se arsyeja e formulimit të kërkesës për shtyrje të datës së zhvillimit të tenderit publik është fakti se ky operator gjëndet në situatën e arritjes së një marrëveshje për transferimin e të gjitha aksioneve të tij tek një grup investitor, argument i cili mbetet tërësisht i njëjtë me kërkesën e parë të sipërmarrësit “Telekom Albania”, dhe për të cilin AKEP ka mbajtur qëndrim me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.92, datë 27.11.2018.
7. Në përfundim, vlen të theksohet se kërkesa zyrtare e sipërmarrësit “Telekom Albania”, nuk përmban asnjë element apo argument të ri të pashqyrtuar më parë dhe në këto kushte AKEP nuk mund të përmbushë kërkesën e sipërmarrësit “Telekom Albania”, për më tepër kur një kërkesë e tillë nuk përmban argumente shtesë ligjore.
8. AKEP konstaton se aktualisht nga sipërmarrësi të paktën në raport me Institucionin tonë nuk ka ende një komunikim zyrtar shpresor mbi ndjekjen e procedurës për dhënien e pëlqimit për transferimin e aksioneve sipas parashikimeve dhe në zbatim të pikës 3 dhe 4, të nenit 7, të Rregullores nr. Nr.30, datë 05.12.2013 “*Për dhënien e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave*”, si dhe të kushteve të përgjithshme të vendosura në Autorizimet Individuale, si nga organi rregullator apo edhe të procedurave ligjore për miratimin e transaksioneve nga institucionet e tjera përgjegjëse për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.
9. Gjithashtu siç theksuam edhe më lart, një procedurë e tillë tenderimi e një brezi mjaft atraktiv për tregun e komunikimeve elektronike nuk mund të shtyhet për një afat të padeterminuar.

PËR KËTË ARSYE:

Mbështetur në pikën 1 të nenit 114-të Ligjit nr. 9918/2008 “*Për Komunikimet Elektronike ne Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, të VKM-së Nr.1252 datë 10.09.2008 “*Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave*”, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të rrëzojë kërkesën e sipërmarrësit “Telecom Albania” sh.a, me objekt “*Kërkesë për shtyrje të mëtejshme të datës së Tenderit për spektrin 800 MHz*”.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Integritimit të njoftoj sipërmarrësin “Telecom Albania” sh.a, lidhur me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar
Ilir ZELA

Anëtar
Klarina ALLUSHI

Anëtar
Ketrin TOPÇIU